

PARALELE FRAZEOLOGJIKE TË SHQIPES ME GJUHË TË TJERA TË BALLKANIT

Xhevat Lloshi
Jani Thomaj

Instituti i Gjuhësisë
dhe i Letërsisë
(Tiranë)

809.198.3—8
KUD 801—8(497)
Punim studimor

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Përmbajtje e shkurtër: Në këtë studim autorët bëjnë fjalë për paralelet frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit. Këto frazeologjizma janë shikuar nga aspekti krahasues i kulturave ndërgjuhësore të komunikimit ndërbalkanik të popujve në kontakt.

Frazeologjia e gjuhës sonë, si një nga elementët më të rëndësishëm që përcaktojnë tiparet e një gjuhe dhe ruajnë më gjatë gjurmët e mëvehtësisë e të traditës me të drejtë ka tërhequr vëmendjen e studiusve shqiptarë e të huaj. Është mbledhur një material i pasur faktik, që shtohet për çdo ditë dhe janë bërë përpjekje të frytshme për studimin e tij nga ana semantike, strukturore, baza popullore etj.¹

Lidhur me analogjitë e gjuhëve ballkanike, studimet e deritanishme si në numër dhe në vëllim, në pjesën më të madhe kanë trajtuar konkordancat leksikore ndërmjet këtyre gjuhëve, si huzimet reciproke ashtu dhe ato nga gjuhë të tjera jashtë Ballkanit, kalkimet, paralelet e strukturave semantike të fjalëve, përdorimet

¹ Për veçoritë semantiko-strukturore të frazeologjizmave të shqipes ka disa punime: A. Xhuvani, *Mbi thjeshtësinë e gjuhës* (1921) në „Studime gjuhësore”, Tiranë, 1956, f. 11—12; N. Bulka, *Frazeologjia shqipe* (lokucionet) në *veprën e Naim Frashërit „Histori e Shqipërisë”* në „Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shkenc. Shoq.” 1957 Nr. 1(3); M. Çeliku, *Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, id. 1962, Nr. 2; J. Thomaj, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, në „Studime filologjike” 1964, Nr. 2—3; *Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes*, id. 1966, Nr. 1, etj.

e figurshme analogjike të fjalëve, etj.², kësaj i duhen shtuar edhe analogjitë e vërejtura lidhur me sistemin fonetik e morfologjik të gjuhëve. Kjo vjen nga që, siç dihet, është natyrë e fenomenit të afërimit të gjuhëve, që në fushën e leksikut të krijohen më të shumtat analogji qysh me kontaktet e para. Duke trajtuar analogjitë leksikore, studiuesit i ka tërhequr edhe ngjashmëria e ndërtimit të shumë „lokacioneve”, „shprehjeve”, në të shumtën e rasteve togfjalësha të qëndrueshëm frazeologjikë.

Krahas kësaj duhet thënë se punimet për analogjitë përgjithësisht i përmbahen një koncepti më të gjerë për frazeologjinë, në krahasim me nocionin frazeologji gjuhësore, që, me sa dimë, po përvijohet sot në linguistikë. Kjo gjen pasqyrimin e vet edhe në mënyrën e dhënies së frazeologjisë gjuhësore në fjalorët e sotëm të tipave të ndryshëm.

Në vargun e problemeve e çështjeve të shumta lidhur me konkordancat gjuhësore ballkanike dhe, në një kënd pamjeje më të ngushtë, me paralelet frazeologjike, kemi zgjedhur si objekt të kësaj kumtese ata togfjalësha të qëndrueshëm frazeologjikë, që janë ngjizur historikisht dhe që funksionalisht janë ekuivalente me një njësi të vetme leksikore, d.m.th. sikurse fjala, kanë funksion emërtues, si p.sh. shq. *ve dorë*, rum. *a pune mînă* bullg. *слагам ръка* gr. e re *βάζω χέρι* (në të gjitha kuptimet), serbokr. *staviti ruku na nešto*; shq. *ka dorë* (vjedh), bull. *има р^бка*, ndër-sa rum. *are mînă lungă* dhe serbokr. *biti dugih ruku* (kam dorë të gjatë); *me kuçkë e me maçkë*, bullg. *с кучета и скотки*, etj.

Përgjithësisht i jemi mbajtur mendimit se parësoret (jo nga rëndësia, por nga vargëzimi i problemeve, nga ecuria metodike në përshtatje me këtë varg problemesh dhe nga lehtësia e trajtimit) në studimin e morisë së problemeve të frazeologjisë së kësaj apo asaj gjuhe janë: e para, zbulimi i tipareve të përgjithshme dhe veçorive kombëtare të frazeologjisë së secilës gjuhë veçmas (lidhur edhe me diferencimin stilistikor, me dendurinë e sferat e përdorimit etj.); e dyta, zbulimi i së përbashkëtës dhe i së ndryshme së kësaj apo asaj gjuhe, në krahasim me gjuhë të tjera simotra.

Në përputhje me këtë, si pikënisje për krahasim për ne ka shërbyer gjithnjë shqipja. Ky kriter nuk është përdorur për të paracaktuar karakterin shqip të burimit të frazeologjizmave të cituar, por sepse gjithashtu i përmbahemi mendimit që, për arsyet e mësipërme, frazeologjia, si vetë leksiku, në fazën fillimtare të studimeve duhet parë jo në mënyrë të diferencuar nga pikëpamja

² Shih p.sh. Per Paphaghi, *Parallele Ausdrücke und Redens-arten im Rumänischen, Albanisischen, Neugriechischen und Bulgarischen*, *Vierzehnter Jahrbuch des Instituts für Rumanische Sprache*, Leipzig; 1908, f. 113—114; shih edhe A. Xhuvani, *Rumänisch-albanische Übereinstimmungen*, *Cercetări de Lingvistică. Supliment, Anul III, 1958*, f. 561—563.

e shtresëzimit, e burimeve, por si një sistem unik e pasuri e përbashkët kombëtare. Rrjedhimisht, gjurmimi etimologjik i frazeologjizmave del kështu në fund të vargut të problemeve të kësaj fushe, si kurorëzim i përfundimeve të arritura nga studimi i çështjeve që e paraprijnë, i hapin rrugën dhe lehtësojnë zgjidhjen e këtij problemi aq të rëndësishëm e të ndërlikuar. Krahas me zbulimin e burimit, me këtë mënyrë do të arrihet të veçohet ai fond i frazeologjizmave, që është tipik ballkanik. Por ky diferencim këtu nuk është bërë gjithënjë, meqë nuk lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e shtruarjes së problemeve në këtë kumtesë. Dy arsyet e përmendura më sipër na kanë shtyrë edhe të kërkojmë analogjinë e ndryshmerinë jo të frazeologjizmave të veçantë të shqipes në krahasim me gjuhë të tjera të Ballkanit, por të tipave semantiko-strukturorë të tyre.

Duke mbajtur parasysh tiparet e përgjithshme të frazeologjisë së gjuhës, vetëkuptohet që konstruktet, të cilat kanë më pak se dy fjalë emërtuese, përdorimet e figurshme të fjalëve të veçanta, qoftë edhe në rastet kur ato i mbartin këto kuptime në konstrukte fjalish, si edhe proverbat, fjalët e urta, gjë e gjëzat, citatet e proverbializuara etj., nuk do të shihen si fakte të frazeologjisë gjuhësore. Ato mund të shërbejnë si elementë krahasimi në fusha të tjera të leksikut, semasiologjisë, folklorit etj. Megjithatë paralele të tilla leksiko-semantike dhe të elementëve të folklorit i ndeshim jo rrallë ndërmjet gjuhëve të ndryshme të Ballkanit, gjë që e vlen të përmendet këtu, siç janë rastet shq. plakatë, rum. babele ose zilele babelor, ar. moasile, bullg. бабини дни, gr. e re οί μέρες τῆς γριᾶς (Pap. 117):³ shq. e lidhurë, ar. cîrleagă ose cirle-di (Pap. 129: Ros. 124),⁴ shq. as për ilaç, rum. nici o leacă, ar. niti trā ileaçë, bullg. нито за лек, gr. e re οὔτε γιά γιαιτρικό (Pap. 120) etj.⁵

Për paralele semantike ose të përdorimeve të fjalëve në kontekste të ndryshme sillen gjithashtu dëshmi të mjaftueshme në punimet e cituara më sipër, si shq. „djali nxori një dhëmb, rum. fiçorlu scoase un dinte, ar. bacatul a scos un dinte, bullg. избоди си детето зъб, gr. e re τό παιδί ἔβγαλε ἓνα δόντι (Pap. 138) etj.

Edhe për elementët e folklorit, si proverbat, gjë e gjëzat, të thënat popullore, fjalët e urta, citatet e proverbializuara etj. është vënë re edhe prej të tjerësh, se në këtë lëmë gjuhët e Ballkanit kanë konkordanca të shumta. Kjo shpjegohet, veç arsyes së tjera, edhe me atë element të përbashkët të botës shpirtërore të

³ Per. Papahaghi, *vep. e cit.*; këtu e tutje jepet me këtë shkurtime.

⁴ Al. Rosetti, *Istoria limbii romîne*, vol. II, Bukuresht, 1962, f. 124; këtu e tutje jepet me këtë shkurtime.

⁵ Për shembuj të tjerë shih punimet e cituara të P. Papahaghi, A. Xhuvanit, Al. Rosettit si dhe E. Çabej, *Parallele Austrücke und Redensarten in den Balkanrachen* në „Revue internationale des études Balkaniques, Beeograd, 1956, I.

popujve të Ballkanit, që Sandfeldi e sheh si një nga faktorët e bashkësisë ballkanike.⁶ Duhet shtuar edhe fakti, që folklori në të gjithë lëndën e tij është një fushë e hapët për ndikime reciproke. Me këto shpjegohen analogjitë e përbashkëta të shpeshta në proverbat e fjalët e urta të popujve të Ballkanit: shq. prit gomar të mbijë bar, bullg. трай, коно за трава, serb. ne crkni magarče do zelene trave; shq. për një plesht djeg jorganin, bullg. изгаря јоргана заради бълхата; shq. parja e bardhë për ditë të zezë, rum. (a strange) bani albi pentru zile negre, bullg. бели пари за черни дни; shq. kau lidhet për brirësh, burri për fjalësh, bullg. вол се врџва за рогата, а човек за езика, serbokr. vo se veže za rogove, а човек за jezik; shq. mali me mal nuk piqet, njeriu me njerinë piqet, bullg. гора с гора не се среџа, човек с човек среџа; shq. digjet i njomi me të thatin, bullg. покрај гухото гори и суровото; shq. ujku qimen ndërron, zakonin s'e harron, bullg. вълкот козината си мени, зџбите си не мени; shq. (u rrukullis) tenxherja gjeti karakun, rum. џi-a găsit tingira capacul, bullg. тџркулнала се тенджерата, намерила си похлупака; shq. në vend t'i vinte vetullat, i nxori dhe sytë, bullg. в место да изпише вежди-извадил очи: shq. dardha nën dardhë bie, bullg. крушата не пада далеч от дџрвотоси, serbokr. kruška pod krušku; shq. ç'piell maceja-gjuan mij; gr. е re ὅτι γεννᾶ ἢ γάτα κωνηγᾶ ποντικοῦς (Krist. f. 66);⁷ shq. dardha e ka bishtin prapa; bullg. има си крушка опашка.

Ka dhe asish që i kalojnë kufijtë e Ballkanit.

verbat e fjalët e urta të popujve të Ballkanit: shq. prit gomar Analogji ndeshen edhe në ato konstrukte, që qëndrojnë ndër-mjet proverbave e të thënave popullore dhe togfjalëshave frazeologjikë, p.sh. shq. gjete kishë (xhami) të falesh, serbokr. našao si crkву gde ješ se bogu moliti; shq. i lirë në miell, i shtrenjtë në krunde, rum. scump la tărățe џi jeftin la făină, bullg. евтин на брашното, скџп на триците etj.

E veçanta, e ndryshmja këtu shprehet në mënyrën se si ndër-tohen proverbat e fjalët e urta, në mbështetjen e njësisë proverbiale mbi këtë ose atë nocion të veçantë që shërben si pikënisje, siç del pjesërisht te ndonjë shembull i përmendur më sipër, po kështu edhe shq. s'e vlen barra qiranë, rum. nu face ata cat fata (nuk bën peri sa faqja); shq. i rrahur me vaj e me uthull, bullg. аз сџм врял и кипял (jam i zjerë e i valuar); shq. dardha nën dardhë bie, rum. așchia nu cade departe de tulpină (gjembi nuk bie larg gjembaçit); shq. i bie pragut të dëgjojë dera, rum. a bate șeama să priceapă iapa (i bie samarit të dëgjoj pela), bullg. тебе дџмам, дџще сещай се, снахо (i flasë vajzës, të kujtohet nusja), serbokr. čerku kara-snaši prigovara (i bërtet së bijës ta dëgjojë e reja);

⁶ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique* (Problèmes et resultats), Paris, 1930, f. 7.

⁷ K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, 1961; këtu e tutje jepet me këtë shkurtim.

shq. ku di dhia ç'është tagjia, bullg. разбира ли ти свина от кладенчова вода? (ku di derri ç'është ujët e burimit); shq, kujto qenin, bëj gati shkopin, bullg. за вълка приказваш, а вълкот в кошарата (kujto ujkun, ai është tek kosharet), serbokr. mi ovuku, a vuk na vrata (përmend ujkun, dhe e ke te dera); shq. ha bukën, përmbys kupën, bullg. из тъкакала си платното, ритнала кросното (end pëlhurën e shkelmon vegjën), serbokr. kad se svinja najede, koriti prevali (kur ngopet derri, përmbys koritën); shq. sipas kokës edhe festen, bullg. според юнка и калпака (sipas trimit edhe festja) ose на такава глава, такъв бръснач (ajo kokë atë brisk do); shq. s'çalon gomari nga veshët, bullg. зъб го боли, та куца (i dhemb dhëmbi e çalon) etj.

Do të ishte interesante të gjurmoheshin edhe shkaqet si të analogjisë, ashtu edhe të ndryshimeve në këto materiale nëpërmjet studimit të tyre në secilën gjuhë veçan, zbulimit të veçorive kombëtare që shprehen në to, mënyrës së realizimit gjuhësor etj. dhe në planin krahasues ndërballkanik, nëpërmjet gjurmimit të kushteve dhe rrethanave të formimit të këtij fondi, të burimit (me anë të huazimit, kalkimit ose të formimit të pavarur brenda gjuhëve kombëtare), të ruajtjes së bërthamës fillestare si nga ana e strukturës semantike, ashtu dhe gjuhësore, gjatë huazimeve reciproke të proverbave, sentencave etj. Por ky gjurmim të shpie jashtë analizës thjesht gjuhësore dhe do të kërkonte një punim krahasues me karakter tjetër.

Termet e përbëra të fushave të ndryshme të shkencës, politikës etj. (siç janë p.sh. pikë e vdekur. rum. punct mort, bullg. мъртва точка; shq. shtylla kurrizore, rum. şiră spinării, greq. ἡ σπονδυλική στήλη etj.) të cilët nga disa linguistë përfshihen në fondin e frazeologjizmave gjuhësore⁸ na duket se janë të një natyre tjetër dhe prandaj nuk janë marrë për krahasim.

* * *

Objekt kryesor i kësaj kumtese mbeten konkordancat në lëmin e frazeologjizmave gjuhësorë.

Nga materiali frazeologjik që kemi mundur të mbledhim, vërejmë se konkordancat e shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit në këtë drejtim⁹ po ashtu edhe ndërmjet gjuhëvet të Ballkanit,

⁸ Shih p. sh. В. В. Виноградов, об основных типах фразеологических единиц в русском языке, në А. А. Шахматов, сборник статей и материалов, вып. III. АН СССР, Москва, 1947. f. 339 etj.

⁹ Po shënojmë se elementët e turqishtes në shqipe dhe në gjuhë të tjera të Ballkanit (kemi parasysh materialin frazeologjik) janë parë së bashku me gjithë elementët leksikorë si ndikim i jashtëm, jo organik ballkanik, si të një periudhe relativisht të vonë dhe si të një gjuhe të një tjetër natyre, gjë që nakashtyrë të mos i vemë në plan historik dhe aktual me rrymat e brendshme ballkanike.

nuk janë dhe nuk duhen parë thjesht si përputhje njësisish të veçuara dhe të rastet, por si *paralele tipash, llojesh, kategorish*. Paralele të tilla frazeologjike tipash, llojesh e kategorish të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit vërehen si nga struktura e tyre formale, ashtu edhe nga ndërtimi semantik. Pa i hyrë një paraqitjeje të plotë, shteruese dhe të gjithanshme të këtyre paraleleve, po sjellim këtu vetëm disa nga tipat, llojet dhe kategoritë semantiko-strukturore, që dalin nga shqyrtimi i materialit.

Tipi më i zakonshëm dhe më i pasur, në të cilin shqipja gjen analogjitë e saja në gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat gjuhësorë, të cilët janë formuar si rezultat i shndërrimit të togfjalëshave të lirë në togfjalësha frazeologjike. „Kuptimi i ri krijohet jo me ndryshimin e kuptimeve të fjalëve të veçanta që hyjnë në togfjalësh, por me ndryshimin e kuptimit të të gjithë togfjalëshit në tërësi... Në rastin ideal njësi të tilla frazeologjike kanë si homonim në formë togfjalëshin e lirë, i cili shërben si bazë për krijimin e njësisë frazeologjike”.¹⁰ Rëndësi të veçantë për dallimin e karakterit të togfjalëshit (të lirë ose frazeologjik) në këto raste ka, siç dihet, konteksti: në kontekste të ndryshme i njëjti togfjalësh mund të jetë i lirë ose frazeologjik. Ky tip na del i zakonshëm jo vetëm për shqipen dhe për gjuhët e tjera brenda Ballkanit, por dhe për disa gjuhë jashtë Ballkanit. Këtu po e renditim me të tjerët, jo aq si një tip thjesht ballkanik, se sa si një pikë tjetër ku takohen gjuhët e Ballkanit, si një nga elementët që rrisin fondin e përbashkët të frazeologjizmave të këtyre gjuhëve. Mjafton të krahasohen për këtë shembujt: shq. *hap gojën*, rum. *deschid gura*, bullg. *отворя уста*; shq. *fus hundën (hundët)*, rum. *a-și băga nasul*, bullg. *пъхам си носа*, serbokr. *zabijati nos*; shq. *më del për hundësh (nga hundët)*, rum. *mi-a eșit prin nas*, ar *vi-iși prit nări*; bullg. *излезе ми през носа*, gr. e re *μοῦ βγήκε ἀπ'τῆ μύτῃ* (Pap. 148, Çab. 339).¹¹ serbokr. *izaći će ti to na nos*; shq. *i heq veshin*, rum. *îl trag de urechi*, bullg. *дъпам ушите на някого*, serbokr. *povući koga za uvo*; shq. *kam gisht*, bullg. *имавам пръст*; shq. *mbyll sytë (vdesh)*, rum. *inchid ochii*, bullg. *затворя очи*; shq. *ngre krye*, rum. *ridic cap*, ar. *mut cap*, scol *cap*, bullg. *вдигам глава*, gr. e re *σηκώνω κεφάλι* (Pap. 143); shq. *heq për hundë*, rum. *a duce (a putre) de nas pe cineva*, вода някого за носа, gr. e re *τραβῶ ἀπό τῆ μύτῃ κάποιον* serbokr. *povući za nos*; shq. *i ra hunda*, rum. *i-a çazut nasul*, ar. *il' çādu narea*, gr. e re *τοῦ ἔπεσε ἡ μύτῃ* (Pap. 125); shq. *shtrij (ndej) dorën*, rum. *întind mânu*, bullg. *протегна (простра) ръка*; serbokor. *pružiti ruku*;

¹⁰ Shih С. И. Ожегов. *О структуре фразеологии* (в звязи с проетком фразеологического словаря русского языка) § 17 në Лексикографический сборник, АН СССР. М. 1957; shih edhe В. В. Виноградов. *Об основных типах*.

¹¹ Е. Çabej, *ver. e cit.*; këtu e tutje jepet me këtë shkurtim.

shq. *i ze gojen*, rum. *Ë astup gura*, bullg. *запушвам някому уста*; shq. *i pret gjuha*, dr. e re *Ë γλωττα του κόβει*; shq. *i kthej kurizin (shpinën)*, rum. *Ë întore spotele*, bullg. *обръщам някому гръб*, gr. e re *γυρίζω τά νῶτα*, serbokr. *okrenuti nekome ledja*; shq. *më doli nga dora*, gr. e re *Ëφυγε από τά χέρια μου* shq. *var hundët*, bullg. *провисвам нос*; shq. *i nxjerr (i tregoj) bërrylin*, bullg. *показвам лакът*; shq. *i nxjerr gjuhën*, rom. *Ë scot limba*, bullg. *плезя език*; shq. *mbeti me gojë hapur*, rum. *rămănea cu gura căscată*, bullg. *остана със зяпнала уста*; shq. *nuk e mbanin këmbët*, rum. *piciarele nu-l mai țin*, bullg. *крка го не държат вече*; gr. e re *δέν τοῦ βαστοῦν τά πόδια* (Pap. 135); shq. *më ha kurrizi (shpina)*, rum. *te mănică spinarea*, arum. *ti mica skinarea*, bullg. *яде те гърба*, gr. e re *σέ τρώη ή ράχη σου* (Pap. 120, Ros. 123); shq. *më hëngri veshët*, rum. *mi-a mîncat urechile*, ar. *iu mîcã urecl' ile*, bullg. *изеде ми ушите*, gr. e re *μοῦ Ëφαγε τ'αὐτιά* (Pap. 127); shq. *e ve në thes*, gr. e re *βάζω στό σακκι* shq. *pres gozhdë*, gr. e re *κσβω καρφιά* shq. *do të fut ndënë dhe*, rum. *te bag în pânînt*, ar. *ti bag tu loc*, gr. e re *θά σέ βάλω στό χώμα*, bullg. *ште те накарам в земята* (Pap. 124. Ros. 123), shq. *e hëngri të gjallë*, rum. *l-e mîncat de viu*, bullg. *жив го яде*; shq. *i ktheu patkonjt*, gr. e re *τινάζω τά πέταλα* (i shkundi patkonjt) etj.

Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërme, foljet komponente të togfjalëshave frazeologjike janë nga grupi i foljeve më të zakonshme dhe me strukturë të gjerë semantike, kurse komponentët e tjerë janë të shumtën e rasteve fjalë që emërtojnë pjesë të trupit ose sende të përdorimit të përditshëm.

Kujtojmë se pikërisht origjina e përbashkët indoevropiane shpjegon edhe analogjitë në procesin e formimit të togfjalëshave frazeologjike të këtij tipi. Prandaj nuk mund të shpjegohet gjithnjë me siguri prejardhja e tyre dhe po kështu është mjaft e vështirë të veçohet fondi thjesht ballkanik i këtyre frazeologjizmave, me përjashtim të rasteve të dokumentuara në monumentet e shkruar. Në këtë drejtim, siç kujtojmë, janë të pranueshme dy mundësi: a) Frazeologjizma të këtij tipi të jenë formuar brendapërbrenda gjuhëve, në mënyrë të pavarur e paralelisht me gjuhët e tjera, ashtu siç formohen mbi bazën e secilës gjuhë edhe kategori të tjera leksikore, si marrëdhëniet sinonimike, antonimike etj. Mbi këtë bazë formime të tilla paralele mund të krahasohen ndërmjet tyre, por jo gjithnjë hedhin dritë në përcaktimin etimologjik: b) Frazeologjizma të këtij tipi ka mundësi gjithashtu të jenë formuar në një gjuhë në përputhje me modelin e një gjuhe tjetër, si kalke frazeologjike. E përbashkët mbetet ideja mbi të cilën mbështetet kuptimi frazeologjik i togfjalëshit. Realizimi gjuhësor i kësaj ideje mund të ndryshojë në vartësi nga natyra e gjuhës përkatëse, nga struktura dhe veçoritë e tjera të togfjalëshit të lirë, korespondues i togfjalëshit frazeologjik. Këtu nuk është fjala për kalimet e togfjalëshave frazeologjike nga një gjuhë në tjetrën, por për

huazimin e një procesi të tërë të shndërrimit semantik të togfjalëshit të lirë në frazeologjik, për një huazim dhe konkordancë, si të thuash tipologjike. Edhe për shqipen si burim i tipit të shndërrimit mund të jetë një gjuhë ballkanike ose jashtëballkanike.

Pa dyshim, në përcaktimin e etimologjisë së frazeologjizmave, një gjë që duhet mbajtur parasysh nga studiuesit, është edhe prejardhja e komponentëve të tyre. Kështu mund të mendohet për një huazim tipologjik sllav ose latin te frazeologjizmat shqipe me elementë leksikorë sllavë ose latinë.¹² Nga ana tjetër, ky kriter që duket bindës, mund të çojë në gabime, mbasi mund të jetë huazuar vetëm fjala dhe jo konstrukti.¹³ Ky problem i vështirë, por mjaft i rëndësishëm mbetet për t'u zgjidhur nga etimologët.

Analogjia tipologjike mbetet me vlerë edhe atëhere, kur ndonjë nga gjymtyrët e frazeologjizmit të shqipes ka si koresponduese të vetën një fjalë me kuptim tjetër leksikor në paralelin e vet frazeologjik të gjuhës që merret për krahasim. Esenciale është se në të dy rastet kemi të njëjtin tip formimi, shndërrimin e togfjalëshit të lirë në togfjalësh frazeologjik. Le të krahasohen për këtë shembujt: shq. *i hedh hi syve*, rum. *a arunca praf in ochi*, bullg. *хвърля прах в очите*, serbokr. *baciti komu prašinu u oči* (në të tria: *hedh pluhur në sy*); shq. *mbaj sëpatën nën gunë*, bullg. *дъжа камък за пазухой*, (mbaj gurin në parzëm, në gji); shq. *i lëpij këmbët*, rum. *îi linga tălpile* (i lëpij thembrat) etj.

Me tipin e mësipërm lidhet edhe formimi i frazeologjizmave, që e ruajnë idenë e krahasimit, bile shpeshherë të shprehur edhe gjuhësisht. Edhe në këtë kategori shqipja gjen analogji në gjuhë të tjera të Ballkanit, p.sh. shq. (dukem) *si pulë e lagur*, rum.: *ca o curcă plouată*, bullg. (изглеждам) *като мокра кокошка* shq. (shkoi) *si qeni në vreshtë*, gr. e re *πάει σαν τό σκυλί στ'ἀμπέλι* shq. *si mishit me thoin*, rum. *a fi unghie și carne* (cu cineva) (Xhuv. 563);¹⁴ shq. *rri mbi gjemba*, bullg. *стоя на бодаи*, shq. *e di ujë*, gr. e re *τό ξερώ νερό*; shq. *m'u bë syri bakërr ar. ocl'il' bācāe nisi feaṭira* (Pap. 122) etj.

Veç këtyre, shqipja gjen në gjuhë të tjera të Ballkanit paralele edhe të atyre frazeologjizmave, që ndërtohen mbi bazën e hiperbolës: shq. *e bëj mizën buall*, rum. *a face din țânțār armăsar* (e bëj mizën hamëshor), bullg. *от мухата слон правя* (e bëj mizën elefant) serbokr. *praviti od muhe vola* (e bëj mizën ka); shq. *e ngre në qiell*, bullg. *вдигам го в небесата* etj.

¹² P.sh. mendojmë se krahas fjalës *besë*, serbokroatishtja të ketë marrë nga shqipja edhe ndërtimin *jap besën*, në përshtatje edhe me domlet e saj.

¹³ Kështu mendojmë se ka ndodhur me shprehjen *bie në godi*, e cila do të jetë formuar në shqipen, mbasi nuk e kemi ndeshur në serbokroatishten, nga është marrë fjala *godi*.

¹⁴ A. Xhuvani, *vep. e cit.*; këtu e tutje jepet me këtë shkurtim.

Një tip gjithashtu i pasur, në të cilin shqipja gjen analogji me gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat, që formohen nga një fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë dhe nga një fjalë me kuptim të figurshëm. Ky tip mund të ketë si korespondues të vetin kuptimor në ndonjë gjuhë një fjalë të vetme, të ndërtuar nga shkrija e komponentëve të frazeologjizmit (delokutiv, p.sh. *a-şi bati joc / a batjocori* „tallem”).¹⁵ Më shpesh ndodh që fjala koresponduese të ndërtohet mbi bazën e njërit prej komponentëve, p.sh. *i zë besë / besoj*, rum. *a face chef / a chefui*; ndeshen edhe raste, kur kanë si koresponduese një fjalë krejt tjetër.

Në këtë tip fokus semantik është më shpesh elementi nominal; elementi verbal (në frazeologjizmat foljorë) që është zakonisht boshti gramatikor, disi desemantizohet. Po sjellim disa shembuj: shq. *merr zjarr* (ndizet), gr. e re *παίρνω φωτιά (ανάβω)*; shq. *i fus frikën*, rum. *bag frica*, bullg. *вдъхвам страх*, gr. e re *τοῦ μπάζω τὸν φόβο*; shq. *i ngul sytë*, rum. *înfig ochi*, bullg. *впервам (впивам) очи*; shq. *i zë besë*, bullg. *хващам явра*; shq. *mbliðh mendjen*, ar. *adunā-tī mintea*, bullg. *събирай си ума*, gr. e re *μάζεψε τα μυαλά σου* (Pap. 156); shq. *bëj me sy*, rum. *a face cu ochiul*; shq. *bëj fjalë*, rum. *a face vorbă*, gr. e re *κάμνω λόγον* etj.

Me këta dy tipat e fundit lidhet edhe një grup tjetër i pasur, që veç në shqipen e ndeshim dhe në gjuhë të tjera të Ballkanit. Fjala është për frazeologjizmat, që ndërtohen semantikisht mbi bazën e kuptimeve të figurshme të komponentëve përbërës. Karakteristikë për ta është se në çdo rast kuptimi i tyre i mundshëm është vetëm ai frazeologjik. Konstrukte të tilla nuk ndeshen në gjuhë si togfjalësha të lirë, meqenëse atëhere, nuk do të kishin kuptim: ose edhe po të përdoren si të tillë, nuk kanë lidhje semantike me togfjalëshin frazeologjik. P.sh. shq. *s'ja pret koka*, rum. *nu-l-taie capul*, ar. *nu-l* ose *nu-l'ta'e capu*, bullg. *не му сече главата*; gr. e re *δέν τοῦ κόφτει τὸ κεφάλι* (Pap. 143, Çab. 228, Ros. 123); shq. *ha dru*, ar. *mîcā lemn*, gr. e re *τρώγω ξύλο* (Pap. 127) khs, bullg. *яде дървен господ* ose *яде бој (дърво)* (Çabej, 227); shq. *më ndizet gjaku*, rum. *îmi aprinde singele* (Xhuv. 562); shq. *mos prish gojën*, rum. *nu-ți strica gura*, bullg. *не си разваляй устата* gr. e re *μή χαλνᾷς τὸ στόμα σου ἄδικα* (Pap. 147, Çab. 228, Ros. 124); shq. *doli nga fjala*, rum. *eși din cuvîntul său*; ar. *iși di zbor*, gr. e re *βγῆκε ἀπ'τό λόγο του* (Pap. 137); shq. *i vret të trasha*, ar. *tal'e groase*, gr. e re *τοῦ κόφτει χοντρές*

¹⁵ Shih E. Benveniste, *Les verbes délocutifs*, në „Studia Philologica litteraria in honorem L. Spitzer”, Berne, 1958, f. 57—63, siç citohet nga F. Dimitrescu, *Despre verbale „delocutive”*, në revistën „Studii și cercetării lingvistice”, I.XII. nr. 3, Bukuresht, 1961, f. 307—309. Shtojmë për shqipen se rastet *vërej*, *bëzaj*, *zëvendësoj* etj. janë gjithashtu delokutivë, por formohen nga tipa të tjerë frazeologjizmesh.

(Pap. 150) etj. Në këtë tip dallimet e shqipes nga gjuhët e tjera janë më të mëdha. Për shumë frazeologjizma të shqipes s'kemi mundur të gjejmë paralele frazeologjike të të njëjtit tip në gjuhë të tjera të Ballkanit, p.sh. *ze ngoje, shes mend, më shkon fjala, i bëj bisht* (punës) etj.

* * *

Si në aspektin semantik edhe në pikëpamje të ndërtimit formal, analogjitë në frazeologjizmat mund të gjurmohen në disa drejtime. Kështu shqipja gjen paralele të plota ose tipologjike në gjuhë të tjera të Ballkanit jo vetëm për tipin foljor (si në shembujt e mësipërm), por edhe për tipat emërorë, mbiemërorë e ndajfoljorë, si: shq. (s'kam) *ditë të bardhë*, rum. (a nu avea) *zi alba* (Xhuv., 561); shq. (kërkoj) *kallëz në dëborë*, gr. e re (ζητεί) *στάχεις ἐπί τῆς χιόνος* (Krist. 146), khs. bullg. *търся под вола теле* *kërkoj* *viçin nën kaun*); shq. (do) *kalë jeshil*, rum. *cai verzi* (*pe pereti*), gr. e re *πράσινα ἄλογα* (Pap. 133, Çab. 227, Ros. 123); shq. (njeri) *i hurit dhe i litarit*, bullg. (човек) *от кол и влже*, gr. e re (ἄνθρωπος) *τοῦ σχοινοῦ καί τοῦ παλουκιοῦ*; shq. *mësallë me dy faqe*, bullg. *двоелика лопата* (*lopatë me dy faqe*), gr. e re *δικρόσωπος ἄνθρωπος*; shq. *me bisht në shalë*, khs. bullg. *подвия си опашката* (*me bisht mbledhur*), *cu coada între picioare* (*me bisht mes këmbëve*); shq. *me faqe të bardhë*, ar. *cu faṭā albā* (Pap. 165);¹⁶ shq. *me gjysmë goje*, rum. *cu jumătate de gură*, ar. *cu gūmitat di gurū*, gr. e re *μέμισό στόμα* bullg. *с половин уста* (Pap. 1—35); shq. *me plot gojën*, bullg. *с пълна уста*; shq. *me kokë në torbë*, ar. *aestu lucru-i caplu tu tastru*, gr. e re dial. *αὐτή ἢ δουλειά εἶναι κεφάλι σέ τρουβᾶ* (Pap. 143, Çab. 228); shq. *me shpirt ndër dhëmbë* (*në gojë*); khs. rum. *cu sufletul la gură*, ar. *cu suflitlu la gurā*, bullg. *душата му е в зъбити*, gr. e re *μέτῆψυχή στό στόμα* (Pap. 147, Çab. 264, Ros. 123); shq. *nga sytë këmbët*, khs. bullg. *където ти видят очите* (*ku të shikojnë sytë*); shq. *sa çel e mbyll sytë*, khs. rum. *a clipi din ochi*; shq. (jetoj) *hiq e mos e këput* gr. e re *τράβα το καί μή τό κόβεις* (Krist. 354) etj. Një pjesë e këtyre shembujve, siç dihet, janë përfshirë në fondin e ballkanizmave tërësore a të pjesëshme prej K. Sandfeldit e të tjerëve.

Por analogjitë më të forta shqipja, në plan tipologjik, i ka në tipin foljor të frazeologjizmave. Paralele të tilla ajo i gjen në gjuhë të tjera të Ballkanit pothuajse në të gjitha modelet strukture të këij tipi. Po sjellim shembuj për disa tipa që përbëhen nga një folje dhe një emër (foljor ose jo foljor), ndajfolje ose gjymtyrë tjetër jo foljore: shq. *i jap besim*, rum. *a da creză mânt*

¹⁶ Në greqishten i ndeshim si kompozita:

(crezar), gr. e re *δίδω πίστι(ν)*; shq. *běj be*, gr. e re *κάνω ὄρκιο*, rum. *fac jurământ* (ar. *džurat*) (Pap. 146); shq. *běj çudi*, serbokr. *činiti čudo*; shq. *běj dëm*, gr. e re *κάμνω ζημίαν*, serbokr. *činiti šteti*; shq. *běj shaka*, rum. *a face glume*, bullg. *правя шега*, serbokr. *napraviti šalu*; shq. *běj udhë*, rum. *fac drumi*, ar. *faccale*, gr. e re *κάνω δρομο*, bullg. *правя път* (Pap. 164); shq. *mos më çaj kokën*; rum. *nu-mi despica capul!* ar. *nu-ñi disicã caplu*, gr. e re *μή μου ξεσκίσης τό κεφάλι* (Pap. 167); shq. (s') *çaj kokën*, bullg. *ломитү гла бугу*, serbokr. *lupati glavu*; shq. *ve bast*, rum. *puì prinsoare*, ar. *bag baste*, gr. e re *βάζω στοιχημα* (Pap. 155), shq. *vij rrotull (vërdallë)*, gr. e re *έρχομαι γύρω* shq. e *ve përpara*, gr. e re *βάζω τινά εμπρός*; shq. e *sjell rrotull (një punë)*, gr. e re *τά φέρνω γύρω* shq. *i marr prapa (fjalët)*, bullg. *вземам си назад думите*; shq. *ve në (ndër) mend*, rum. *imi pun în minte*, ar. *inñ bag tu minte*, bullg. *түрям на ум*, gr. *βάζω στό νοῦ μου* (Pap. 156); shq. *marr nëpër këmbë*, rum. *a lua peste picior* (Pap. 130), si edhe shembuj të tjerë, që janë dhënë gjatë kumtesës për tipat e përmendur.

Numri i këtyre tipave strukturorë është, pa dyshim, më i madh se kaq, po të mbajmë parasysh mundësinë që ka shqipja dhe gjuhët e tjera të Ballkanit për të ndërtuar frazeologjizma me kategori të ndryshme leksiko-gramatikore, me rend tjetër fjalësh etj. E veçanta në shqipen dhe në gjuhët e tjera del nëpërmjet ndryshimeve strukturorë të tipave gjatë shprehjes gjuhësore të të njëjtit kuptim frazeologjik, kështu që shqipja nuk gjen gjithnjë paralele të përgjithshme ballkanike, por gjen konkordanca të pjeshme herë me një gjuhë, herë me një tjetër. Është një gjë e ditur gjithashtu që disa frazeologjizmave të shqipes u përgjigjen në gjuhë të tjera fjalë të vetme, kompozita ose frazeologjizma të një tjetër tipi. Mjafton të krahasohen: shq. *më nxore mentë*, gr. e re *μέ έξερνω ἄλιος* shq. *ve mënjane* gr. e re *βάζω στή μπάντα* etj.

Një tip interesant nga struktura, në të cilin shqipja gjen analogji në gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat me shkallë të ndryshme njësimi semantik dhe idiomatizimi, që formohen me anë të përsëritjes së një fjale, ose me bashkimin e dy fjalëve semantikisht korelative (sinonime ose antonime) nëpërmjet të fjalëve shërbyese. Në ndonjë gjuhë të Ballkanit ato ndërtohen edhe pa ndihmën e fjalëve shërbyese. P.sh. shq. *ditë për (më) ditë*, rum. *zi cu zi*, ar. *duã cu duã*, gr. e re *μέρα μέ τή μέρα* (Pap. 159), bullg. *от ден на ден*, serbokr. *od dana na dan*; shq. *javë për javë*, rum. *săptămină de săptămină*, bullg. *от седмица на седмица*: shq. *vit për vit*, rum. *an de an*, gr. e re *ἀπό έτος εις έτος*, bullg. *от година на година*, serbokr. *iz godine u godinu* etj.; shq. *sy ndër sy*, bullg. *очи на очи*; shq. *zi e më zi*, serbokr. *sve crnje i crnje*; shq. *krah për krah*, bullg. *рамо до рамо*, serbokr. *rame u rame*; shq. *brez pas brezi*, serbokr. *od pasa na pas*, bullg. *от поколения до поколение*; gr. e re *εις γενεās γενεών*, rum. *din*

generaþiune în generaþiune; shq. *hap pas hapi*, rum. *pas cu pas*, bullg. *корак за корак*, serbokr. *korak po korak*, gr. e re βῆμα πρὸς βῆμα shq. *fill e për pe*, rum. *din fir a pâr* (Xhuv. 562), ndërsa bullg. *от игла до конец* (nga gjilpëra deri në fund); shq. *kokë e këmbë*, rum. *din cap până'n picioare*, bullg. *от главата до краката*; shq. *gjerë e gjatë*, bullg. *надълго и нашироко*, serbokr. *надуго и нашироко*; shq. *lart e poshtë*, (*posht' e lart*), bullg. *нагоре-надолу*.

Siç shihet dhe nga vetë shembujt, mjetet gjuhësore ndihmëse që përdoren në ndërtime të tilla për bullgarishten dhe serbokroatishten ndryshojnë, por tipi strukturor mbetet po ai.

Nga ana tjetër tipi me përsëritje në urdhërore të foljeve antonime ose me kuptim përafërsisht të kundërt a të foljeve të bashkëkushtëzuara semantikisht është karakteristik për shqipen: *fol e qesh, qesh e ngjesh, shkel e shko, ec e jak* etj. Edhe të tjerë frazeologjizmave nuk kemi mundur t'u gjejmë analogjitë përkatëse: *pilë më pilë* (kudo), *flakë për flakë*, (shkonin) *thik'e brisik, lesh e li, me laçka e me plaçka, orë e pa kohë, të lan e të lyen* etj.

Megjithatë, siç kemi shënuar kalimthi edhe më sipër, mëvetësia kombëtare e secilit popull shprehet në frazeologjizmat gjuhësore jo vetëm me anë të strukturës origjinale të tyre, të natyrës së komponentëve, të rendimit të fjalëve, të mënyrës dhe mjeteve lidhës etj., por edhe me pikënisjen origjinale, që shërben si semantemë për kuptimin e frazeologjizmit. Kështu i njëjti kuptim frazeologjik realizohet në gjuhë të ndryshme me mënyra dhe mjete të ndryshme, duke pasur për bazë nocione të ndryshme me nuanca karakteristike sipas frymës së këtij ose atij populli.¹⁷ Kës. për këtë shq. (i shkon) *si shala gomarit*, bullg. (прилича му) *като на свина звинец* (si dërrit zilja) ose *като на сврака трака* (si laraskës troka, këmbora); shq. *si kofini pas të vjeli*, bullg. *след дъжд качулка* (pas shiut kapuçin); shq. *i ka marrë koka erë*, bullg. *има м бръмбари в главата* (ka brumbuj në kokë); shq. *i doli boja*, rum. *și-a dat arama pe fată* (i doli bakri nga fytyra), shq. *mos i krih bishtin*, rum. *nu-i cănta mult în carne* (mos i këndo shumë pas bririt); shq. *s'kam sy e faqe*, ndërsa te të gjithë të tjerët: *nuk kam fytyrë të ...*: rum. *n'am obraz să...*, ar. *no-am față să...*, bullg. *нямам лице да*, gr. e re *δέν έχω πρόσωπο* ose *δέν έχω μούτρο* vά... (shih dhe Pap. 132); shq. *e kam halë në sy*, bullg. *като трън в очите*, serbokr. *biti nekome trn u oku* (të dyja: gjemb në sy); shq. *i vete pas avazit* (hedh këmbën pas daulles), bullg. *вървя по гайгата на някого* (eci pas gajdes së dikuj) etj.

¹⁷ „Duke kaluar nga njera në tjetrën prej këtyre gjuhëve, siç ka shkruar Kr. Sandfeld për gjuhët e Ballkanit, — turqishtja dhe shpesh gjithashtu serbokroatishtja lihen mënjanë, — të bie të konstatosh që shumë shpesh është vetëm leksiku dhe fleksioni që ndryshojnë dhe që natyra e të shprehurit mbetet në esencë po ajo mbi gjithë teritorin e mbuluar nga këto gjuhë, — shih Kr. Sandfeld, *vep. cit.* f. 6.

Veç për tipat e përmendur më sipër shqipja gjen paralele në gjuhë të tjera të Ballkanit edhe për ata frazeologjizma përgjithësisht të rinj, që janë formuar nën ndikimin e modeleve të huaja, shpesh të karakterit ndërkombëtar, si elementë kryesisht të gjuhës së shkruar, të gazetës, librit, radios, zyrës etj. p.sh. *ve në votë*, rum. *a pune la vot*, bullg. *поставям на гласување*, serbokr. *staviti na glasanje* (khs. it. mettere ai voti, rus *поставить на голосование* etj.), shq. *marr vendim*, rum. *alua o hotărîre*, bullg. *вземам решение*, gr. e re *παίρω από αση* (khs. it. prendere una decisione, rus. *принимать решение* etj.); shq. *marr pjesë*, rum. *a lua parte*, bullg. *взема участие*, gr. e re *παίρω μέρος*, serbokr. *uzeti udela* (khs. it. prendere parte, rus. *принимать участие* etj.); shq. *bën përshypje*, rum. *a produce, a face o impresiune*, bullg. *направя впечатлени*, serbokr. *učiniti utisak* (khs. fr. faire impression,¹⁸ gjerm. *Eindruck machen* etj.) etj.

Në këtë kategori frazeologjizmash e përbashkëta, që mbështet, siç u tha, në burimin e tyre, është pa dyshim kryesorja. Por, nga ana tjetër, edhe në ta shprehen veçoritë e strukturës së secilës gjuhë. Secila gjuhë i ndërton sipas natyrës së vet, shpesh në përputhje me modelet ekzistuese të vetat. Kjo u çel rrugën që të përhapen jo vetëm në gjuhën e shkruar, por edhe në atë të folurën. Le të krahasohen për këtë shembujt e mëposhtëm: shq. *hedh* (ngre) *në gjyq*, rum. *a da, a trage, a trimite în judecată* (jap, tërheq, dërgoj në gjyq), bullg. *подавам под съд* (e jap në gjyq), kurse ar. scol. *virā la ġudet*, gr. e re *σηκώνω κανένα στόν καθή* (Epirus),¹⁹ shq. *hedh (dorëzohj) armët*, rum. *a depune armele* (jap, le armët), bullg. *слагам оръжие (le, vë armët)* gr. e re *καταθέτω τά όπλα*; shq. *hedh në shportë*, bullg. *түря под миндера* (*hedh nën minder*) etj. Kjo kategori frazeologjizmash, natyrisht e rrit fondin e përbashkët të frazeologjizmave të gjuhëve të Ballkanit, megjithatë do veçuar mirë nga ata të gjuhës së folur popullore, sepse akoma dallohet si një kategori elementësh të gjuhës së shkruar e përgjithësisht të jashtëm.

* * *

Siç është përmendur edhe te ndonjë nga tipat e analizuar më sipër, përcaktimi i etimologjisë së frazeologjizmave gjuhësorë është shumë i vështirë. Megjithatë kërkimet e studiuesve lehtësohen dhe mund të orientohen nga disa tregues gjuhësorë, që ek-

¹⁸ Prof. A. Xhuvani e nxjerr të burimit freng, shih *Mbi thjeshtësinë e gjuhës* (1927) në „Studime gjuhësore”, Tiranë, 1956, f. 15.

¹⁹ Shih Per. Papahaghi, *ver. e cit.* f. 121; prof. E. Çabej e shikon në greqishten e Epirit si një përkthim nga shqipja ose arumanishtja, *ver. e cit.* f. 226. khs. gr. *ένάγω στό δίκη*.

zistojnë në vetë frazeologjizmat. Në një shkallë më të madhe se sa gjurmimi i etimologjisë së kësaj ose asaj shprehjeje veçan, këtu ka rëndësi gjurmimi i tipave të frazeologjizmave, lidhur me natyrën e kësaj ose asaj gjuhe. Prandaj në fazën e parë të kërkimeve del nevoja e zbulimit, e njohjes dhe e përcaktimit të tipave të frazeologjizmave në secilën gjuhë, si edhe krahasimi me gjuhë të tjera, për të gjetur çka është e përbashkët e çka është e ndryshme ndërmjet tipave. Pikërisht këtu treguesit gjuhësorë dalin me vlerën e tyre të plotë, jo vetëm për të na përçuar drejt gjuhës, nga e cila buron ky apo ai frazeologjizëm, por për të na treguar edhe të kundërtën, se ku ky burim nuk duhet kërkuar. Kështu, p.sh. në frazeologjizmat foljorë, si: shq. *bëhem rezil*, bullg. ставям за резил; shq. *bëj gajret*, bullg. чини гайрет; shq. *bëj kail*, bullg. старям кайл; shq. *kam merak*, bullg. мерак ми е; shq. *shtie merak* në diçka, bullg. хвърлям мерак на нещо; shq. *e bëj për pesë para*, rum. *a face de două parale* (e bëj për dy para); bullg. паправя го за пет пари; shq. *bëj qef*, rum. *a trage un chef*; shq. *i bëj qefin*, rum. *a face cuiva cheful*, bullg. правя си кефа му; shq. *s'e prish qefin*, bullg. не си разваля кефа; shq. *bie në bela*, bullg. Испдам в беля; shq. *fus në bela*, rum. *a băga pe cineva în belea*; shq. *kam gjetur belanë me ty*, rum. *mi am găsit beleana cu tine*, gr. e re βοήκη τόν μπελά μέ σένα (Xhuv. 562); shq. *nuk del hesapi*, ar. *nu case h'isapea* (Pap. 137); shq. *daj mejdanin*, bullg. деля мегдан с някого, serbokr. *megdan dijeliti*; shq. *e ka hak*, bullg. хак му е; shq. *të qoftë hallall*, bullg. да ти халаал; shq. *s'kam haber*, bullg. нямам хабер (от работата); shq. *bëhem sakat*, *bëhem pishman*, *bëhem telef*, *bëhem teslim*, *bëhem helaq*, *bëj zapt*, *bëj zarar*, *bëj rixha*, *bëj jemin*, *bëj hyzmet*, *bëj hile*, *bëj hasha*, *bëj kabull*, *bëj derman* etj,²⁰ — fjalët turke janë treguese, që pritej të na çonin drejt burimit turk të këtyre frazeologjizmave, porse nga ana tjetër duke qenë se, siç dihet turqishtja depërtoi mjaft në gjuhët e popujve të Ballkanit, elementët leksikorë turkë nuk duhen marrë gjithnjë si tregues të sigurtë të burimit turk për tipat e frazeologjizmave; të asimiluar plotësisht nga pikëpamja gjuhësore, këta elemente janë shfrytëzuar si të ishin elementë vetiakë për të ndërtuar frazeologjizma tipash të ndryshëm brendapërbrenda kësaj apo asaj gjuhe, gjë që del dhe me krahasimin e konstrukteve në shqip emër + folje, kurse turqisht folje + emër (p.sh. shq. *i ve zjarrin*, tq. *ateşe vermek*; shq. *var turinjtë*, tq. *surat asmak*; shq. *ngul këmbë*, tq. *ayak basmak*; shq. *sjell ndër mend*, tq. *akila getirmek*. Edhe vetë fjalët turke, që janë komponente të frazeologjizmave gjuhësorë të shqipes, siç vemë re edhe te ndonjë gjuhë tjetër e Ballkanit, nganjëherë kanë pësuar zhvillime semantike të mëtejshme.

²⁰ Shumë nga këta frazeologjizma i përkasin vetëm gjuhës së folur popullore.

Përsa u përket raporteve të shqipes me turqishten në frazeologjizma me elementë leksikorë të kësaj gjuhe të fundit, këtu Miklosiçin (Ueber die Enwirkung des Turkischen auf die Grammatik der südosteuropäischen Sprachen në Sitzungsberichte d. Wiener Akad. Phil. Hist. Cl. 120), dhe Sandfeldin (vep. e cit. f. 159) se turqishtja është gjuha më e re në Ballkan dhe me origjinë e strukturë të ndryshme nga të tjerat, kështu që konstruktet e frazeologjizmave të turqishtes nuk kanë gjetur paralele strukturore tipologjike si në shqipen, si në të tjera gjuhë të Ballkanit, por janë përshtatur sipas modeleve ekzistuese të gjuhëve përkatëse. Prandaj edhe konstrukti turk *emër + folje* është përmbysur në *folje + emër*: tq. *belâ almak* — shq. *i nxjerr bela*; tq. *qabul etmek* — shq. *bëj* — *çajmë mës* 'bq. :ηηαρη shq. *bëj seir*, gr. *νά κάνουν σεῖρι* serbokr. *kulu sehir*, bullg. *чинит сеир*. Ka asish që janë rregulluar që para ngulitjes së turqve në Ballkan, p.sh. tq. *teslim etmek*, maq. bullg. *сторвам теслим*; tq. *haber almaq*, shq. *marr haber*, gr. e re *παίρω χαμπέρι*. Në shqipen, si dhe në greq., bullg., serbokr., maq., emri te këto togje mbetet turqisht, kurse folja është vendëse²¹. Dihet gjithashtu se jo gjithnjë turqishtja merr pjesë në bashkësinë ballkanike²² dhe jo çdo gjuhë e Ballkanit është prekur në frazeologji nga ndikimi turk njësoj.

Përsa u përket frazeologjizimeve me elementë sllavë, grekë ose neolatinë, që i gjejmë në shqipen dhe në ndonjë gjuhë tjetër të Ballkanit, ata duhen parë gjithashtu po nën këtë prizëm, veçse ndryshe nga frazeologjizmat me elementë turkë, për ta burimi mund të kërkohet jo vetëm për komponentët veçmas, por edhe për tipin e ndërtimit të tyre, pavarësisht nga ndryshimet në strukturë, meqenëse këtu është rasti i gjuhëve të një familije. Kështu mund të vështrohen rastet shq. *fus fitila*, gr. e re *βάζω φυτίλια*; shq. *humbas pusullën* (busullën), gr. e re *χάνω τόν μπουσουλά μου*; shq. *i jap dum*, gr. e re *δῶς του δρόμο* rum. *a da drumul*²³ etj.

Vlera e treguesit gjuhësor në këto raste plotësohet edhe me rrethanat pak a shumë të përbashkëta në jetën e popujve të Ballkanit. Me këto rrethana lidhet, për shembull, edhe kategoria e frazeologjizmave, që i përkasin sferës fetare dhe që janë përhapur nëpërmjet kishës, xhamisë dhe letërsisë fetare. Kështu për shq. *ve kurorë* (kurorëzoh, kurorëzohem), burimi i formimit të saj, siç e ka vënë re Kr. Sandfeld (vep. e cit., 35; shih edhe Per. Pap. vep. cit., 143) shpjegohet me greqishten *βάζω στεφάνια* (*στεφανόνω* lidhur me ritin martesor grek (Kr. Sandfeld, po aty), prandaj si në shqipen e gjejmë edhe në rumanishten *a puna cununie*, ar. *bāgāc (u) runā* Pap. 143). Me këtë rrugë mund të ndiqet burimi

²¹ Kr. Sandfeld, vep. e cit. f. 159.

²² Po aty, f. 163.

²³ Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe IV*, „Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq.” 1961, Nr. 3, f. 67.

i shprehjeve të tjera të kësaj natyre: shq. *bie në mëkat*, rum. *cade în păcat*, bullg. *изпадам в грях*, serbokr. *pasti u greh*; shq. *bëj mëkat*, rum. *fac păcat*, bullg. *върша грях*, serbokr. *učiniti greh*; shq. *jap shpirt*, gr. e re *παραδίδω τό πνεῦμα*; shq. *i laj duart* prej nji gjâje, rum. *a se spăla pe mâini* de ceva (Xhuv. 502) shq. *marr më (ndë) qafë*, gr. e re *παίδνω στό λαίμω* (Krist. 197) etj.

Si gjuhët e tjera edhe shqipja përgjithësisht frazeologjizma-ve, ashtu si elementëve të tjerë gjuhësorë u ka veshur petkun shqiptar, në përputhje me mjetet gjuhësore dhe modelet që ajo ka. Kështu, tregues të tillë si ndërtimi me një gjymtyrë në rrjedhoren më *-sh*, me parafjalë me përdorime karakteristike, me gjymtim të modelet fillestar apo me rënie të fjalëve shërbyese etj., tregojnë që, së paku në strukturën e tyre të jashtme, këta frazeologjizma janë karakteristikë për shqipen. P.sh. *marr më sysh*, khs. ar. *l'au di ocl'u*, gr. e re *παίρνω από μάτι* (Pap, 122), bullg. *хващам уроки* shq. *lua j mënj (mëndsh)*, khs. gr. e re *ἔσάλεψε ὁ νοῦς του* serbokr. *šenući umom*, rum. *i-au sărit minți*; shq. *bie mbë gjak*²⁴ khs. gr. e re *διέπραξα φόρον* (kreva vrasje, Krist, 124); *ditën për diell*, (khs. bullg. *посред бял ден* dhe serbokr. *usred bela dana*), *ja fus këmbët në një këpucë, s'e ha atë kokërr ulliri, flas kodra pas bregut, me lugë në brez, shkoi për dhjamë qeni, ve buzën në gaz*; — shq. *e vuna (+ ujin) mbë vijë*, khs. gr. e re *ἔβαλα νερό εἰς τό αυλάκι* (Krist. 384); shq. *i dal (+ për) zot* (khs. gr. *προστατεύω τινά*, bullg. *застъпвам се*, serbokr. *za uzeti*; se); shq. *marr (+ me) vesh*²⁵, khs. ar. *l'au di ureacle*, gr. e re *παίρνω από ταῦτί* (Pap. 150); shq. *bëj (+ me) mend* etj.

Vijnë për të përmendur këtu edhe frazeologjizmat, që kanë elementë leksiko-semantikorë dhe bazë krahasimore karakteristike për shqipen, ndonëse mund të kenë paralele tipologjike në gjuhë të tjera të Ballkanit, si p.sh. *ha shqip* (edhe gr.) khs. bullg. *разбирам ли от българска* (merr vesh bullgarisht); *ka duk*; *ve kujen*, khs. gr. *βάζω τά κλάμματα* (ve të qarët); *vë re*; *i bëjmë pipëzat bashkë*; *ha ana*; *dredh bishtin* (vdes), *bëj një sy qorr*, khs. rum. *închid un ochi* (mbyll një sy), bullg. *прався се на сляп* (bëhem si i verbër), serbokr. *zažmuriti jednim okom* (mbyll një sy); *e gjeti kokën e kandilit*; *bëhem teneqe*; *mbeti pajë*; *sa të hanë qentë*; *si cjapi te kasapi, si breshka te nallbani* etj.

Së fundi, shtojmë se duhen parë si të shqipes ata frazeologjizma, që lidhen dhe motivohen me ngjarje konkrete historike ose episodike të truallit shqiptar dhe që nuk gjejnë paralele në gjuhë

²⁴ Lidhur me zakonin shqiptar të gjakmarrjes.

²⁵ Me shembullin *mbaj mend* shqipja ka analogji të plotë me rum. *tinminte*, ndoshta nga një burim i tretë i përbashkët, siç ve re P. e r. P. a h a g h i *vep. e cit.* f. 156, it. *tener mente*; në gjuhë të tjera të Ballkanit ndeshet me parafjalë, khs. po aty bullg.

të tjera të Ballkanit²⁶ si: (u zunë) *për mustaqet e Çelos*, (e pagoi) *si (sa) frëngu pulën*, (e humbi) *si Xhaferi simiten*, *i bëhet ferra Brahim*, *i bie legenit*, *shkoi dushk për gogla*²⁷ etj.

* * *

Gjithë sa u tha dëshmon se konkordancat në frazeologji spikatin në sistemin e përgjithshëm të bashkësisë Ballkanike. Nga ana tjetër po kaq qartë spikatin këtu edhe veçoritë e secilës gjuhë, gërshetuarazi me gjithë kompleksin e veçorive kombëtare të historisë së secilit popull në të gjitha aspektet e jetës së tij.

Në fushën e analogjive del se e përbashkëta shprehet më tepër te pikënisja e ndërtimit semantik të frazeologjizmave gjuhësorë dhe proverbave, gjëzave etj., ku në shumicën e rasteve shërben afërsisht po ai nocion, po ajo ide në popuj të ndryshëm të Ballkanit (madje dhe jashtë Ballkanit). Nga pikëpamja semantiko-strukturore më të zakonshmet janë konkordancat e pjeshme të shqipes me këtë apo atë gjuhë të Ballkanit se sa ato të përgjithshmet. Kështu shqipja ka me bullgarishten analogji më të forta në frazeologjizmat e formuar me fjalë turke dhe në elementët e folklorit (proverba, të thëna popullore etj.), me greqishten në frazeologjizmat që lidhen me sferën kishtare dhe në disa të tjerë (si: *humbas pusullën*, *i jap dum*, *ve në vijë*, etj.), gjë që dëshmon për një bashkëmarrëdhënie më të lashtë e më të gjatë. Më të shumta janë analogjitë tipologjike. Tipi i frazeologjizmave të formuar si rezultat i shndërrimit të një togfjalëshi të lirë në frazeologjik, që gjendet edhe në gjuhë të tjera indoevropiane, është i zakonshëm edhe te të gjitha gjuhët e Ballkanit. Edhe dy tipat e tjerë, ku më shumë e ku më pak, i ndeshim pothuajse kudo.

Tipare të përbashkëta gjejmë gjithashtu edhe në mënyrën e dhënies e të përdorimit të frazeologjizmave gjatë procesit të shkëmbimeve në mes gjuhëve si brendapërbrenda Ballkanit, ashtu dhe me gjuhë të tjera.

Por nga shkalla e produktivitetit të këtyre tipave secila gjuhë ka veçoritë e saj. Më tepër shqipja afron me rumanishten. Në gjuhë sllave të Ballkanit, më fort në serbishten, shqipja gjen si ekuivalente të frazeologjizmave të saj të shumtën e herës jo frazeologjizma, por fjalë të vetme. Bullgarishtja në këtë drejtim qëndron më afër me shqipen e rumanishten në krahasim me ser-

²⁶ Disa frazeologjizma të kësaj kategorie lidhen me ngjarje dhe anekdota të përhapura në Ballkan, veçanërisht me anë të folklorit, p.sh. shq. *e kam mizën në kësulë*, rum. *mă sint cu musca pe căciulă*, gr. e re *οτοιος, ξκσι, τή μύγα μυγιάζεται*; shq. *lëshoj brezin*, gr. e re *κρέμω τό ζωνάρι* etj.

²⁷ Për dy të fundit shih Instituti i Shkencave, *Përralla popullore*, Arkivi i Institutit të Folklorit, vëll. I. f. 37.

bishten, megjithëse janë të një grupi, gjë që mund të shpjegohet me një ndikim më të madh ballkanik mbi të.

Këtu duhet pasur parasysh edhe ndikimi nga jashtë Ballkanit, siç del qartë me fondin e frazeologjizmave relativisht të rinj të gjuhë së shkruar.

Edhe në ndërtimin formal shqipja gjen paralele të saja në gjuhë të tjera të Ballkanit, veçanërisht në tipin foljor (sidomos folje + emër foljor ose jo foljor). Përsëri këtu bie në sy afëria më e madhe e shqipes me rumanishten dhe pas saj me greqishten. Folje të tilla si *bëj, marrë, vë* etj., ose fjalë që emërtojnë pjesë të trupit si *sy, dorë, kokë* etj.²⁸ si në shqipe, ashtu dhe në greqishte e veçan, në rumanishten këto paralele frazeologjike du-gjizmach, paralele si nga struktura kuptimore, ashtu dhe nga ndërtimi formal. Për rumanishten këto paralele frazeologjike duhen parë në një sistem të vetëm me afërinë e madhe që ka kjo me shqipen edhe në anë të tjera të gjuhës.

Analogjitë tipologjike, që dalin të përgjithshme e të zakonshme me secilën gjuhë të Ballkanit, përbëjnë anën e brendshme, thelbësore të bashkësisë ballkanike në lëmin e frazeologjisë. Mospërputhjet në njësi të veçanta të këtij apo atij tipi, si nga figurat mbi të cilat ndërtohen, ashtu dhe nga mënyra e mjetet e shprehjes gjuhësore të tyre, e nxjerrin të ndryshmen si të jashtme, por jo me pak thelbësore në studim. Kështu tregon edhe shqipja tiparet e saj nëpërmjet ndërtimit të frazeologjizmave, që nuk kanë paralele të tyre në gjuhë të tjera të Ballkanit.

Është krejt e kuptueshme që gjer tani është hequr vetëm hullia e parë në këtë fushë kaq të gjerë e të rëndësishme, ku çdo problem në veçanti pret studime të gjithanshme e të hollësishme, nevoja për të cilat kuptohet vetiu si në plan teorik, ashtu edhe në praktikën leksikografike.

Nga njëra anë këto studime do të nxjerrin në dritë fondin frazeologjik të gjuhëve me një jetë të gjatë në gojjen e popullit dhe me vulën popullore si dhe lidhjet, bashkësinë e ndryshimet e gjuhëve në këtë fushë. Nga ana tjetër do të zgjidhin mjaft probleme praktike të hartimit të fjalorëve një ose dy gjuhësh. Detyra jonë e parë është që kjo pasuri e madhe dhe me vlerë e krijuar gjatë shekujve nga goja e popullit të mblidhet me kujdes e të studiohet mirë brendapërbrenda shqipes.

²⁸ Mjafton të krahasohet p.sh. shq. *gojët e këqia, nga goja në gojë, me gjysmë goje, hyj në gojë të botës, me bark te goja, ja marr fjalën nga goja, mbetem me gojë hapur, s've gjë në gojë, më lëshon goja lëng, etj.* Rum. *gurile rele, din gură in gură, cu jumătate de gură, a intra in gură lumii, cu bortul la gură, a lua vorbadin gură, a rămănea cugură căscăta, nu pune nimic in gură, îi lasa gura apă* etj. Ndonjë nga këto ndeshet dhe në gjuhë të tjera.

Xhevat Lloshi, Jani Thomaj

PARALLELES PHRASEOLOGIQUES DE L'ALBANAIS
AVEC D'AUTRES LANGUES BALKANIQUES

R é s u m é

L'essence de l'exposé ci-contre en albanais est de faire ressortir que les concordances dans la phraséologie jaillissent, dans leur ensemble, des éléments communs balkaniques. D'autre part, en toute évidence jaillissent aussi les particularités de chaque langue, en s'imbriquant à tout l'ensemble des particularités nationales historiques de chacun de ces peuples, sous tous les aspects de leur vie.

Dans le domaine des analogies, il ressort que le commun est exprimé dans le point de départ de la construction sémantique des combinaisons phraséologiques linguistiques et des proverbes, devinettes, etc., ou, dans la plupart des cas, sert approximativement la même notion, la même idée chez des peuples différents des Balkans (et même en dehors des Balkans). Au point de vue sémantico-structurel, plus habituelles sont les concordances partielles de l'albanais avec l'une ou l'autre langue balkanique, que celles générales. Ainsi, l'albanais a, d'avec le bulgare, les analogies plus fortes dans les combinaisons formées à l'aide de mots turcs et dans les éléments du folklore (proverbes; dictons populaires, etc.); d'avec le grec, dans les combinaisons du domaine ecclésiastique et dans quelques autres (telles: *humbas pusullën, i jap dum, ve në vijë*, etc.), ce qui atteste de l'existence de rapports plus anciens et plus persistants. Dans la plupart des cas il s'agit d'analogies typologiques. Le type de combinaison, formée à la suite de la modification d'une combinaison libre en phraséologique, qu'on trouve également dans d'autres langues indo-européennes, est commun aussi à toutes les langues des Balkans. Aussi, les deux types sont rencontrés, qui plus qui moins, un peu partout.

Des traits communs se retrouvent aussi dans la façon d'extérioriser et d'usiter les phraséologismes durant le processus des échanges entre les langues, aussi bien à l'intérieur des Balkans que d'avec les autres langues.

Néanmoins, au point de vue de la productivité de ces types, chacune des langues a ses particularités propres. L'albanais se rapproche davantage au roumain. Dans les langues slaves des Balkans, l'albanais trouve dans le serbocroate un plus grand nombre d'équivalents de ces combinaisons phraséologiques, la plupart du temps non point des phraséologismes, mais de seuls mots. Le bulgare, considéré sous cet aspect, tient davantage à l'albanais et au roumain par rapport au serbe, quoique ces deux langues soient du même groupe, ce qu'on peut expliquer par une influence balkanique plus forte sur elle.

En cela on doit avoir présent, naturellement, aussi l'influence extra-balkanique, comme il ressort parfaitement dans le fond des combinaisons phraséologiques relativement récentes de la langue écrite.

Dans la construction de la forme, aussi l'albanais trouve des parallèles dans les autres langues balkaniques, notamment dans le type verbal (surtout verbe + nom verbal ou non verbal). On a ainsi une plus grande affinité de l'albanais avec le roumain et ensuite le grec. De tels verbes comme *bëj*, *mar*, *vë*, etc., ou bien des mots indiquant des parties du corps, tels *sy*, *dorë*, *kokë*, etc., aussi bien en albanais, comme en grec et notamment en roumain, ont un cercle assez ample de combinaisons phraséologiques parallèles aussi bien comme structure sémantique que comme construction de forme. Pour le roumain, ces parallèles phraséologiques doivent être vus dans un système unique par rapport au grand voisinage qu'il a avec l'albanais aussi sous d'autres aspects de la langue.

Les analogies typologiques, qui résultent générales et communes avec chacune des langues balkaniques, constituent l'aspect intérieur, essentiel de la communauté balkanique dans le domaine de la phraséologie. Les non-concordances dans des unités particulières d'un type ou d'un autre, aussi bien comme figures sur lesquelles elles sont construites, que du mode et des moyens d'extériorisation linguistique, font résulter la différence comme extérieure, particulière, mais toujours aussi essentielle à être étudiée. C'est ainsi qu'aussi l'albanais fait voir ses traits propres à travers la construction des combinaisons phraséologiques qui n'ont pas leurs parallèles dans d'autres langues des Balkans.

On comprend parfaitement que jusqu'à maintenant on n'a fait que le premier sillon dans ce domaine aussi vaste et aussi important, où chaque problème particulier attend des études détaillées et à plusieurs égards, et dont le besoin est parfaitement compréhensible aussi bien sur le plan théorique que dans la pratique lexicographique.

Sur ces problèmes il serait d'une grande utilité que pour chacune des langues soit publié de la façon la plus complète le patrimoine phraséologique, qu'on entreprenne la rédaction de dictionnaires phraséologiques et de dictionnaires comparés de deux ou plusieurs langues.